



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, më 08.05.2018



RAPORT PËR MUAJIN PRILL 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë inspektuar të gjitha kompanitë e transportit publik, taksit legal dhe është bërë largimi i taksive ilegal duke marrë të gjitha masat e nevojshme sipas Ligjit të Transportit Rrugor. Me këtë rast është bërë Plan Operativ duke realizuar kontrolla në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësi në Drenas, që nga data 23.04.2018 çdo ditë, duke përfshirë edhe ditët e vikendit.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar ka vazhduar me inspektime të marketeve rreth kontrolles së produkteve ushqimore dhe është konfiskuar një sasi prej (250 kg) produkte pa afat dhe janë zhvilluar procedurat e nevojshme ndaj subjekteve. Gjithashtu gjatë këtij muaji janë inspektuar furrat e bukes rreth higjenes dhe afatizimit të produkteve të përdorura.

Inspektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka vazhduar me janë mbikëqyr ndërtimet në qendër të qytetit dhe në zonën komosative përgjatë dy anëve të autosdradës “M9” nga Arllati e deri në Korroticë të Epërme si dhe përgjatë dy anëve të rrugës Drenas – Komoran.

Gjithashtu edhe këtë muaj ka qenë pjesë e Komisionit për vlerësim të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore dhe fakteqësive tjera; Komisionit për verifikim të pronave të paluajtshme; Mbikëqyerje të projektit në rregullimin e varrezave faza e II.

Inspektori i Komunikacionit në zbatim të Planit Operativ, ka bërë inspektime rreth transportit të udhëtarëve me rëndësi të veçant, kontrollë e Operatorëve ilegal si dhe rendin e udhëtimit të Operatorëve legal, ku gjatë këtij muaji janë konfiskuar 9 targa dhe 27 automjete të transportuesve ilegal. Gjatë realizimit të këtij plani operativ është autorizuar edhe Inspektori i Tregu, Pajazit Hamza për kryerjen e detyrave të Inspektorit të Komunikacionit.

Inspektori i Tregut me rëndësi të veçantë ka inspektuar bizneset e reja të pa regjistruara, sidomos ato të lojërave të fatit, duke obliguar për tu pajisë me dokumentacionin e nevojshëm për biznes, ndërkaq 6 prej tyre janë mbyllur deri në plotësim të dokumentacionit.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime të mjedisit në shqyrtim të kërkesave të palës, në veqanti inspektimin e Qendrave të mjekësisë familjare dhe bizneseve rreth hyrjes së tyre në sistem të menagjimit të mbeturinave.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punes në shifra për muajin prill 2018:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjoha mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit pa afat
I.Sanitare	22	1	2		1	1					250 kg
I.Tregut	27	6					1	1	6		
I.komunikacionit	47			3						9T,27A	
I.Ndërtimit	19	8	1				7	7			
I.Ambientit	26		1				2	2			
Totali	141	15	4	3	1	1	10	10	6	9+27	250 kg

Maj, 2018

U.D Shef i Inspektionit: Ariana Sadiku